



**Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare në
bashkëpunim me
Bankën Botërore
përmbyll projektin për
liberalizimin e sigurimit
të detyrueshëm motorik
dhe mundësitë e
tarifimit me bazë risku**

Vijon në faqen 2



VËSHTRIM MBI TREGJET

**Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në
Shqipëri për periudhën janar-mars 2013**

Vijon në faqen 4

**Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave
me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-
mars 2013**

Vijon në faqen 4

**Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private
Vullnetare për vitin 2012**

Vijon në faqen 5

ZHVILLIME TË TJERA

**Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes
Financiare, Znj. Enkeleda Shehi merr pjesë
në mbledhjet e nënkomiteteve teknike të
IAIS-it (9-11 prill)**

Vijon në faqen 5

**Seminar mbi fleksibilitetin e siguruesve në
kohën e ndryshimeve financiare (9-11 prill)**

Vijon në faqen 6

**Trajnimi i 23-të ndërkombëtar mbi zhvillimin
e tregut të letrave me vlerë (15-25 prill)**

Vijon në faqen 7

**Forumi: “Evolucioni Teknologjik i Botës
Financiare (25 prill)**

Vijon në faqen 8

**Mbledhja katërt e Nënkomitetit për Tregun
e Brendshëm dhe Konkurrencën (26 prill)**

Vijon në faqen 9

LAJMET NGA RAJONI

Estoni

Vijon në faqen 10

Kroaci

Vijon në faqen 10

Republika Çeke

Vijon në faqen 10

Rumani

Vijon në faqen 11

Turqi

Vijon në faqen 11



**Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare në
bashkëpunim me
Bankën Botërore
përmbyll projektin për
liberalizimin e sigurimit
të detyrueshëm motorik
dhe mundësitë e
tarifimit me bazë risku**

Vijon në faqen 2



VËSHTRIM MBI TREGJET

**Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në
Shqipëri për periudhën janar-mars 2013**

Vijon në faqen 4

**Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave
me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-
mars 2013**

Vijon në faqen 4

**Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private
Vullnetare për vitin 2012**

Vijon në faqen 5

ZHVILLIME TË TJERA

**Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes
Financiare, Znj. Enkeleda Shehi merr pjesë
në mbledhjet e nënkomiteteve teknike të
IAIS-it (9-11 prill)**

Vijon në faqen 5

**Seminar mbi fleksibilitetin e siguruesve në
kohën e ndryshimeve financiare (9-11 prill)**

Vijon në faqen 6

**Trajnimi i 23-të ndërkombëtar mbi zhvillimin
e tregut të letrave me vlerë (15-25 prill)**

Vijon në faqen 7

**Forumi: “Evolucioni Teknologjik i Botës
Financiare (25 prill)**

Vijon në faqen 8

**Mbledhja katërt e Nënkomitetit për Tregun
e Brendshëm dhe Konkurrencën (26 prill)**

Vijon në faqen 9

LAJMET NGA RAJONI

Estoni

Vijon në faqen 10

Kroaci

Vijon në faqen 10

Republika Çeke

Vijon në faqen 10

Rumani

Vijon në faqen 11

Turqi

Vijon në faqen 11

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Bankën Botërore përmbyll projektin për liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe mundësitë e tarifimit me bazë risku

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) përmbylli projektin për Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri në një *workshop* të organizuar me pjesëmarrjen e të gjitha shoqërive të sigurimit në vend. Ky projekt i cili



po realizohet edhe falë bashkëpunimit me Bankën Botërore, paraqet një mundësi për të kaluar drejt një tarifimi më efektiv, në llogaritjen e primit të sigurimit të detyrueshëm motorik që është ai me bazë riskun. Projekti ka filluar që prej shtatorit të vitit 2011 dhe aktualisht ka të hartuar dokumentet strategjike, që do të përcaktojnë drejtimet kryesore ku do të fokusohen në të ardhmen shoqëritë e sigurimit dhe AMF.

Në prezantimin e këtyre dokumenteve strategjike gjatë *workshop-it* Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi vlerësoi punën e bërë nga ekipi i Bankës Botërore dhe specialistët e AMF-së për ndërtimin e një udhëzuesi i cili do t'i shërbejë si shoqërive të sigurimit ashtu edhe vetë AMF-së në të ardhmen. Znj. Shehi vlerësoi edhe rezultatet e arritura me krijimin pranë AMF-së të Qendrës Kombëtare të të Dhënave për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik, si një njësi mjaft e rëndësishme në drejtim të furnizimit të parametrave të nevojshëm për klasifikimin me bazë risku të marrjes në sigurim të mjetit dhe drejtuesve të tij, duke integruar mundësimin e përqasjes Bonus-Malus.

Ekspertët e Bankës Botërore prezantuan propozimet e tyre për mundësitë që tregu shqiptar ka për ndërtimin e tarifave të primit të sigurimit të detyrueshëm motorik me bazë risku. Ata shpjeguan me detaje duke theksuar eksperiencën e vendeve që e kanë kaluar më parë këtë proces si Italia apo Turqia. Ekspertët theksuan ndërtimin e një baze sa më të plotë të dhënash, përcaktimin e faktorëve që do ndikojnë në përlllogaritjen e primeve të sigurimit, rolin shumë të rëndësishëm të teknologjisë së informacionit dhe krijimin e njësisë kundër mashtrimit në sigurimin e mjeteve motorike.

Sipas këtij projekti është hartuar një plan strategjik veprimi me synimin kryesor që tarifat e sigurimit të detyrueshëm motorik të jenë:

- Të drejta për konsumatorin dhe t'i shërbejnë atij;
- Efikase në drejtim të kostos;
- Nxitëse për një drejtim më të sigurt automjeti duke prezantuar sistemin bonus/malus;
- Të qëndrueshme dhe elastike.

Ekspertët theksuan ndërtimin e një baze sa më të plotë të dhënash, përcaktimin e faktorëve që do ndikojnë në përlllogaritjen e primeve të sigurimit.

Kushtet aktuale të tregut paraqiten të paqëndrueshme dhe kanë krijuar një presion të tillë që çon në luhatjen e çmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik. Krijimi i një tregu ku çmimet janë të stabilizuara është një detyrë e rëndësishme. Eksperienca botërore tregon se kjo arrihet para së gjithash kur shoqëritë e sigurimit janë të maturuara në drejtim të disiplinave të marrjes në sigurim. Në vende të tjera ku janë zbatuar qasje të ngjashme është dëshmuar që frekuenca e aksidenteve rrugore është përgjysmuar pas një periudhe 15-20 vjeçare.

Në zbatim të këtij projekti, AMF ka bërë përmirësime të ndjeshme në Qendrën Kombëtare të të Dhënave për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik, në drejtim të furnizimit të parametrave të nevojshëm për klasifikimin me bazë rrisht të marrjes në sigurim të mjetit dhe drejtuesve të tij, duke integruar mundësimin e përjasjes Bonus-Malus. Një gjë e tillë, i krijon mundësi shoqërive të sigurimit të llogarisin tarifa sigurimi të lidhura drejtpërdrejt me historikun e dëmeve të drejtuesit të mjetit. Të dhënat e nevojshme merren tashmë në kohë reale nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Gjithashtu në sajë të bashkëpunimit dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, të dhënat e Regjistrimit Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike, tashmë shërbejnë dhe për kontrollin në kohë reale të vlefshmërisë së policave me sistemin e kontrollit online të vendosur në qendrat operative “eGjoha”, me qëllim uljen e numrit të të pasiguarve.

Objektivat themelorë të strategjisë së sigurimit të detyrueshëm motorik janë:

- Çmime të sigurimit të detyrueshëm motorik bazuar në rrisht;
- Ndërtimi i mekanizmave të saktë të grumbullimit të të dhënave;
- Reduktimi i mashtrimeve duke ndërtuar edhe mekanizmat e përshtatshëm për t'i luftuar ato;
- Forcimi i kapaciteteve të siguruesve për të menaxhuar bilancet e tyre;
- Minimizimi i numrit të të pasiguarve;
- Prezantimi i reformave të nevojshme ligjore.

AMF beson që në afatgjatë, përfitimet do të jenë në nivel kombëtar dhe do të lidhen me shpejtësinë dhe maturinë më të cilën vetë shoqëritë e sigurimit do të ecin në këtë proces. Në shumë vende një qasje e tillë e strukturuar ka sjellë përfitime për konsumatorin duke ndikuar edhe në uljen e numrit të aksidenteve dhe promovimin e drejtimit më të sigurt të mjeteve motorike. Ndërkohë, AMF do të vazhdojë të monitorojë me kujdes dhe në mënyrë të vazhdueshme politikën e tarifimit të shoqërive të sigurimit dhe shëndetin e tyre financiar, për të garantuar, që siguruesit disponojnë mjetet e nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj publikut.

Në zbatim të këtij projekti, AMF ka bërë përmirësime të ndjeshme në Qendrën Kombëtare të të Dhënave për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik, në drejtim të furnizimit të parametrave të nevojshëm për klasifikimin me bazë rrisht të marrjes në sigurim të mjetit dhe drejtuesve të tij, duke integruar mundësimin e përjasjes Bonus-Malus.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2013


Duke iu referuar të ardhurave nga primet e shkruara bruto, tregu i sigurimeve në vend në tremujorin e parë të vitit 2013 arriti në vlerën rreth 2.09 miliardë lekë. Ky volum tregon një rritje prej 11.96% krahasuar me tre muajt e parë të vitit të kaluar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012 u rrit gjithashtu edhe numri i policave të sigurimit me 6.36% duke arritur në 232,784 polica sigurimi.

Rritja më e madhe u vërejt në produktet e sigurimit të Jo-Jetës, volumi i të cilave u rrit me 12.29% në periudhën janar-mars 2013 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritje më të vogël patën produktet e sigurimit të Jetës me 5.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e *sigurimit të detyrueshëm motorik* arritën vlerën 1.02 miliardë lekë, me një rritje prej 21.92% nga janar-mars 2012.

Dëmet e paguara bruto regjistruan një ulje me 17.68% gjatë kësaj periudhe krahasuar me periudhën janar-mars 2012.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-mars 2013



Materiali i plotë i raportit statistikor për periudhën janar-mars 2013 gjendet në <http://amf.gov.al/news.asp?id=899>

Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2013

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2013 u dominua në masën 84.09% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 15.91% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 94.87% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Rritja më e madhe u vërejt në produktet e sigurimit të Jo-Jetës volumi i të cilave u rrit me 12.29% në periudhën janar-mars 2013 krahasuar me të njëjtën periudhë e një viti më parë.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2013 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 70.18% dhe 18.28% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.43% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Materiali i plotë mbi tregun e letrave me vlerë për periudhën janar-mars 2013 gjendet në <http://amf.gov.al/news.asp?id=896>

Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare për vitin 2012

Gjatë vitit 2012 në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2012 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 283.01 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 128.27 milionë lekë (82.89%).

E shprehur në euro¹, totali i asetëve nën menaxhim është 2.03 milionë euro. Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në fund të vitit 2012 ishte 7,281 anëtarë duke shënuar rritje prej 15.66% krahasuar me fundin e vitit 2011. Materiali i plotë i mbi tregun e pensioneve gjatë vitit 2012 gjendet në <http://amf.gov.al/news.asp?id=898>

¹Kursi zyrtar i këmbimit (“fiksi”) 31.12.2012 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 139.5 lekë

ZHVILLIME TË TJERA

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi merr pjesë në mbledhjet e nënkomiteteve teknike të IAIS-it

(9-11 prill)

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*) zhvilloi në periudhën 9-11 prill në Bon, Gjermani, takime pune të nënkomiteteve të saj teknike.



International Association
of Insurance Supervisors

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi është anëtare e Nënkomitetit të Gjithëpërfshirjes Financiare (*Financial Inclusion Subcommittee*), i cili është një nënkomitet i krijuar vitin e kaluar pranë IAIS-it me synim për të promovuar tregjet që po lindin dhe sidomos ato në vendet në zhvillim. Ai synon të mbështesë aplikimin e Parimeve Themelore

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.43% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

“Gjithëpërfshirja financiare” si term tregon një gjendje në të cilën të gjithë të rriturit në moshë pune kanë akses në kredi, kursime, pagesa dhe sigurime nga ofruesit formale të këtyre produkteve.

të IAIS-it, rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve, si edhe formave të tjera të sigurimeve.

Duke marrë këtë përgjegjësi, Nënkomiteti i Gjithëpërfshirjes Financiare ndër të tjera do të:

- hartojë materiale studimore rreth Gjithëpërfshirjes Financiare;
- promovojë punën e mekanizmave rregullatore që vendosin standarde;
- rrisë dhe promovojë kapacitetet e politikë-bërësve, rregullatorëve dhe mbikëqyrësve duke kërkuar të ecë më tej në ofrimin e aksesit në tregun e sigurimeve për konsumatorët me të ardhura të ulta duke përfshirë këtu edhe përhapjen e informacionit.

Ky nënkomitet do të zhvillojë takime edhe me organizma të tjerë që janë të përfshirë në iniciativa të ngjashme për rritjen e aksesit të të gjithë popullsisë për produktet financiare, siç mund të jenë edhe iniciativat e G20 për Partneritetin Global për Gjithëpërfshirjen Financiare (*Global Partnership for Financial Inclusion*).

“Gjithëpërfshirja financiare” si term tregon një gjendje në të cilën të gjithë të rriturit në moshë pune kanë akses në kredi, kursime, pagesa dhe sigurime nga ofruesit formale të këtyre produkteve.

Gjithashtu Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkelelda Shehi mori pjesë edhe në takimet e Nënkomitetit për Rrjetin e Mikrosigurimeve (*IAIS-Microinsurance Network Joint Working Group*) si edhe të Grupit Hartues për udhëzuesit për çështjet që lidhen me sjelljen e tregut dhe mbrojtjen konsumatore, të zhvilluara në datat 10-11 prill 2013.

Seminar mbi fleksibilitetin e siguresve në kohën e ndryshimeve financiare, Bazel, Zvicër

9-11 prill



Instituti për Stabilitet Financiar (*Financial Stability Institute, FSI*) pranë Bankës për Rregullim Ndërkombëtarë (*Bank for International Settlements, BIS*) organizoi seminarin me temë “Mbi fleksibilitetin e siguresve në një botë financiare në ndryshim”. Seminari u zhvillua në datat 9-11 Prill 2013 në Bazel, Zvicër.

Synimi i seminarit përmes tematikave të trajtuara i shërbeu rritjes së njohurive të mbikëqyrësve në sigurime për një sërë nismash të ndërmarra në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar me synimin për ti bërë siguresit më fleksibël ndaj ndryshimeve të mëdha financiare globale.

Në seminar u diskutuan edhe mjaft nisma që i shërbejnë arritjes së këtij synimi. Ndër këto nisma përmendet ajo e ndërmarrë nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Fondeve të Pensioneve (EIOPA) (*European Insurance and Occupational Pension Authority, EIOPA*) në lidhje me projektin e Solvency II, projekt i cili synon vendosjen e një regjimi prudent për siguruesit dhe risiguruesit në vendet e BE-së. Ky projekt përbën një nga sfidat më të mëdha të punës së EIOPA-s e cila do të shoqërohet edhe me hartimin e udhëzuesve dhe standardeve. Numërohen rreth 53 udhëzues dhe standarde të tilla që duhen hartuar për të mbështetur zbatimin e regjimit të ri, Solvency II. Ky proces parashikohet të përfundojë brenda vitit 2013. Standardet dhe udhëzuesit do të mbulojnë çështje të tilla si kërkesat e kapitalit, fondet e veta, modelet e brendshme, mbikëqyrja e grupit, raportimi dhe transparenca, vlerësimi i asetëve dhe përgjegjësi të tjera nga ato që lidhen me provigjonet teknike dhe drejtimi i shoqërisë.

Në seminar përmes temave të trajtuara u diskutua mbi nevojën e siguruesve për të kuptuar risqet me të cilat ata përballen dhe kërkesat për zbatimin e praktikave të përshtatshme në menaxhimin e tyre.

Çështjet të tjera të trajtuara kishin të bënin me përafrimin dhe kombinimin e kërkesave të Solvency II me riskun e teknikat e menaxhimit të tij, perspektivat e menaxhimit të riskut, arti i mbikëqyrjes, etj. Gjithashtu u diskutua për mësimet e nxjerra nga kriza e fundit financiare globale, siç janë përqsja e standardizuar e modeleve të brendshme të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas eksperiencës së vendeve të BE-së, Zvicrës, Japonisë, SHBA, etj.

Ekspertë të njohur nga EIOPA, IAIS, Deloitte, apo nga autoritetet mbikëqyrëse të Gjermanisë, Japonisë, Zvicrës, Francës dhe SHBA-ve trajtuan në mënyrë interaktive me pyetje dhe diskutime po ashtu edhe nëpërmjet prezantimeve të tyre si aspektet teorike ashtu edhe raste studimore të lidhura me to. AMF u përfaqësua në këtë seminar nga ekspertë në fushën e rregullimit dhe standardeve.


Trajnimi i 23-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë, Uashington, SHBA

15-25 prill

Komisioni i Letrave me Vlerë në SHBA (*Securities Exchange Commission, SEC*) zhvilloi gjatë periudhës 15-25 prill, në Uashington trajnimin e 23-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë. Në këtë trajnim merrnin pjesë përfaqësues nga 72 autoritete të ndryshme rregullatore.

Temat kryesore të këtij trajnimi përfshinin:

Sfidat e rregullatorit të letrave me vlerë. Tematika kryesore lidhej me abuzimet e mundshme me tregun, me konsumatorin dhe rregullat që duhen ndjekur për evitimin e këtyre abuzimeve siç janë rregullat në mbikëqyrje, zbatueshmëri dhe inspektive.



Çështje të tjera të trajtuara kishin të bënin me përafrimin dhe kombinimin e kërkesave të Solvency II me riskun e teknikat e menaxhimit të tij, perspektivat e menaxhimit të riskut, arti i mbikëqyrjes, etj.

Edukimi i investitorëve luan rol në parandalimin e mashtrimeve. Si pika kryesore u theksua nevoja e krijimit të një programi me punonjës të trajnuar dhe kompetentë, të mbështetur nga teknologjia që mundëson investitorët të marrin informacion dhe të kontaktojnë lehtësisht agjencinë mbikëqyrëse.

Skema Ponzi dhe mashtrimi me skemat piramidale. Prezantimet trajtuan mekanizmat e funksionimit të skemave piramidale, investimet mashtruese dhe trajtimi i skemave piramidale më të njohura të viteve në vende të ndryshme.

Ndërtimi i një programi mbi zbatueshmërinë e legjislacionit dhe praktikat më të mira. Nëpërmjet kësaj teme u diskutua mbi forcimin e hetimit dhe ndjekjes së manipulimeve që bëhen në treg. Rëndësi ju kushtua kryerjes së investigimit dhe etapave që ndiqen, bashkëpunimit që duhet të realizohet midis kompanive dhe individëve, përgatitja e një stafi kompetent dhe kërkesat për sjelljen e stafit. Gjithashtu u vu theksi edhe tek zbatimi i ligjeve penale në tregun e letrave me vlerë.

Qeverisja e korporatave. Tema u trajtua si nga analiza mbi teoritë, konceptet dhe principet e saj për qeverisjen. Problemi kryesor lidhej me mbrojtjen e investitorëve të huaj (*pakicat e aksionarëve dhe kreditorëve*) nga shpronësimi i investitorëve të brendshëm (menaxherët dhe aksionarët kontrollues).

Edukimi i investitorëve u cilësua si shumë i rëndësishëm për zhvillimin me sukses të tregut të letrave me vlerë. Kjo lidhet edhe me rritje e numrit të tyre, të produkteve të ndryshme komplekse, të investitorëve “konfuzë”, si dhe mbrojtjen e besimit të tyre. Edukimi i investitorëve luan rol në parandalimin e mashtrimeve. Si pika kryesore u theksua nevoja e krijimit të një programi me punonjës të trajnuar dhe kompetentë, të mbështetur nga teknologjia që mundëson investitorët të marrin informacion dhe të kontaktojnë lehtësisht agjencinë mbikëqyrëse.

Mbikëqyrja dhe zhvillimi i tregut të letrave me vlerë. Qëllimi i kësaj teme ishte shpjegimi i nevojës së një bazë të fuqishme legjislative për funksionimin e tregut të letrave me vlerë.

Tema mbi tregun e brendshëm, manipulimin e tregut, si dhe mashtrimin e kontabilitetit financiar ishin pjesë e rëndësishme e trajnimit. U trajtua studimi për Tregtimin e Shpejtë (*Fast Traders*). Objektivi primar i këtij studimi ishte të mësuarit sesi ekzaminuesit të mund të kryejnë një ekzaminim brokeri. Posaçërisht, ky studim shqyrton rastet kundër pastrimit të parave, tregtisë së paautorizuar, përshtatshmërinë dhe mbikëqyrjen.

Forumi: “Evolucioni Teknologjik i Botës Financiare Sofie, Bullgari

25 prill

Forumi i 15-të “Evolucioni teknologjik i botës financiare u organizua nga Grupi për të Dhëna Ndërkombëtare (*International Data Group of Bulgaria, IDG*), Shoqata për Auditivin dhe Kontrollin e Sistemeve të Informacionit, (*Information Systems Audit and Control Association, ISACA*) dhe qendra Informacioni, Teknologjia e Komunikimit dhe Media, (*Information, Communications Technology and Media-ICT Media*). Ky forum u mbajt në



25 prill edhe falë bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Bullgarisë dhe Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare. Forumi prezantoi sfidat e reja, zgjidhjet dhe tendencat që lidhen me menaxhimin, zgjerimin dhe mbrojtjen e informacionit. Ai paraqiti shembuj për optimizmin e aseteve teknologjike duke përdorur platforma të reja për zhvillimin e produkteve të reja bankare dhe të sigurimeve.

Ndër tematikat kryesore të trajtuara ishin:

1. Zbatimi që teknologjia e informacionit ka në institucionet financiare;
2. Mbështetja që jep teknologjia e informacionit për aktorët e tregjeve financiare;
3. Krijimi i shërbimeve të reja për bankat dhe klientët e tyre duke përdorur teknologjinë e informacionit;
4. Sistemi i pagesave SEPA si kërkesë për pjesëmarrësit e tregut financiar evropian;
5. Sfidat lidhur me aplikimin e teknologjisë së informacionit për kontrollin e institucioneve financiare;
6. Teknologjitë e reja-të nevojshme për efektivitetin mbikëqyrës financiar;
7. Menaxhimi i riskut lidhur me sistemet financiare bankare dhe të sigurimeve.

Pjesëmarrësit në këtë forum ishin ekspertë të teknologjisë së informacionit në nivel rajonal. Folës kryesorë ishin përfaqësues nga Banka Qendrore Evropiane, si edhe ekspertë nga Austria dhe Bullgaria.

Forum i prezantoi sfidat e reja, zgjidhjet dhe tendencat që lidhen me menaxhimin, zgjerimin dhe mbrojtjen e informacionit. Ai paraqiti shembuj për optimizmin e aseteve teknologjike duke përdorur platforma të reja për zhvillimin e produkteve të reja bankare dhe të sigurimeve.

Mbledhja e katërt e Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, Bruksel

26 prill

Në datën 26 prill 2013, në Bruksel, pranë ambienteve të Komisionit Evropian u mbajt mbledhja e katërt e Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, përfshi dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit. Shqipëria u përfaqësua nga një delegacion i përbërë me përfaqësues të lartë të të gjitha institucioneve, sipas programit të takimit.



Për të gjitha pikat diskutimeve në takim u mbajtën në konsideratë zhvillimet më të fundit që nga Nënkomiteti i prillit 2012, me fokus të veçantë zhvillimet pas Raportit të Progresit të muajit tetor 2012, zbatimin e MSA dhe ndihmën aktuale që EU dhe organizatat e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare po i japin Shqipërisë.

AMF u përfaqësua në takim nga Znj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit Juridik dhe Z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit të Kërkim, TI dhe Statistikës. Theksi në diskutimet dhe pyetjet nga Komisioni Evropian ishte tek zhvillimet ligjore, në veçanti tek projektligji për sigurimin dhe risigurimin, ligji për sigurimin e detyrueshëm motorik si dhe tek kapacitetet administrative e institucionale. Pas informimit mbi zhvillimet më të rëndësishme, nga përfaqësuesit e AMF-së, Komisioni Evropian do të bëjë vlerësimet e nevojshme dhe do të shprehet mbi progresin e arritur gjatë vitit 2012 si dhe sfidat e angazhimet e ardhshme që AMF duhet të kapërcejë përgjatë procesit të integritimit.

LAJMET NGA RAJONI

Estoni

Kompanitë estoneze të sigurimit grumbulluan gjatë muajit shkurt rreth 5.6 milion euro në primet e sigurimit të Jetës, ose 14.7 % më shumë se në të njëjtin muaj të vitit të kaluar.

Pagesat në sigurimin e Jetës arritën në 3 milion euro ose 3 % më pak se në shkurt të vitit 2012.

Kompanitë e sigurimit për produktet e sigurimit të Jo-Jetës mblodhën 17.3 milion euro prime muajin e kaluar, 4.8 % më shumë se një vit më parë.



Kroaci

Privatizimi i kompanisë së sigurimeve Croatia Osiguranje dhe bankës Croatian Postal Bank, HPB, në Kroaci po hyn në fazën përfundimtare dhe tenderi pritet të shpallet në fillim të muajit maj. Kjo u deklarua nga Ministri i Financave të Kroacisë Slavko Linic, në Komisionin Parlamentar të Financave.



Republika Çeke

Siguruesit çekë e përfunduan vitin 2012 me një fitim prej 603.6 milionë euro, (të agreguara para taksave) me një rritje prej 36.3% më shumë se në vitin 2011, përkundërt trendit të aktivitetit të marrjes në sigurim.

Primi i shkruar bruto, gjatë vitit 2012 arriti një shumë të primit në total prej 6.1 miliardë euro, ose 1.6% më shumë në krahasim me një vit më parë, duke marrë parasysh vlerat e treguesve kryesorë të tregut të shprehura në euro.

Sigurimi i Jetës regjistroi një rritje prej 2.7% krahasuar me një vit më parë, në euro, me një shumë totale të primit të shkruar bruto prej 2.87 miliardë



euro. Shkalla më e lartë e rritjes së sigurimit të Jetës është raportuar për klasën “*dëmtimi personal ose sëmundje*”, i cili shënoi një rritje prej 12.4% të primeve të shkruara bruto me rreth 381 milionë euro. Nga ana tjetër, pavarësisht rritjes prej 17% të numrit të përgjithshëm të policave, primi i shkruar bruto për “*sigurimi mbi vdekjen, mbijetesën, etj*” është ulur me rreth 4.8%, ose në 848 milion euro.

Primi i shkruar bruto për sigurimin e pronës arriti në vlerën 828.6 milionë euro, ose 3.85% më shumë krahasuar me vitin 2011, ndërkohë që dëmet e paguara për të njëjtën klasë ka pasur një ulje prej 9.2%, ose 354 milionë euro. Në linjat e sigurimeve motorike, gjatë vitit 2012 rezultatet treguan qëndrueshmëri në sigurimin *Kasko*, me një vlerë në primet e shkruara bruto prej 576.7 milionë euro dhe me një rënie prej 2.8% në MTPL, ose 789.6 milionë euro.

Rumani

Në vitin 2012, *sigurimi i pronave* në Rumani raportoi një volum të primet të shkruar bruto prej 280 milionë euro, me një rënie prej 12% në krahasim me vitin e kaluar, sipas të dhënave të publikuara nga INSURANCE Profile. Marrja në *sigurim e dëmtimit të pronës, nga zjarri dhe rreziqet* përfaqësojnë më pak se 15% të tregut.



Në vitin 2012, 11 siguruesit rumunë janë autorizuar për të shitur polica të MTPL-së duke raportuar një rritje prej 10% të vëllimit të biznesit të tyre, i cili në total arriti 2.1 miliardë RON, ose 471.2 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara janë rritur me 11%, duke arritur 1.8 miliardë RON ose 403.9 milionë euro. Raporti i dëmeve të paguara bruto ka evoluar pozitivisht këtë vit, duke arritur në 81% krahasuar me 97% në fund të vitit 2011.

Në vitin 2012, u raportuan 6,779,620 kontrata të sigurimit MTPL-së, ose 6% më shumë se në vitin 2011. Sa i përket dëmeve të paguara kompanitë paguan dëmet për 297,181 dosje, ose 2% më pak në krahasim me vitin 2011.

Turqi

Sektori turk i sigurimeve pritet të hyjë në një periudhë konsolidimi pas shpalljes se kompania gjermane *Germany Allianz* do të blejë biznesin e sigurimit të Jo-Jetës dhe biznesin e pensioneve të kompanisë turke *Yapi Kredi*. Kjo marrëveshje e bën *Allianz Turkey's* siguruesin më të madh të sigurimit të Jo-Jetës, siguruesin më të madh të pensioneve private sipas madhësisë së portofolit si edhe siguruesin e tretë më të madh të sigurimit të Jetës.



Ndërgjegjësimi i ulët i popullsisë në Turqi për riskun po ndryshon. Pjesërisht kjo është e lidhur me zbatimin më të mirë të legjislacionit mbi format e sigurimit të detyrueshëm, si për sigurimin e mjeteve motorike ashtu edhe për sigurimin nga tërmeti.

Sigurimi nga tërmeti për shtëpitë e reja është tashmë një kusht për lidhjen e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të tyre. Por ky sigurim është gjithashtu kusht për shkak të popullatës së re të Turqisë (rreth 30 % e të cilave është nën moshën 30 vjeç), të cilët kanë më tepër me më shumë mundësi se sa prindërit e tyre për të mbajtur karta krediti dhe për të blerë shtëpitë e ndërtuara rishtas. Të dy këta faktorë kanë rritur politikat e shitjes së sigurimit të shtëpive gjatë dekadës së kaluar. Gjithashtu ka ndihmuar edhe vetë sektori i sigurimeve duke ofruar një shumëllojshmëri të produkteve për të apeluar tek konsumatorët e rinj.

Për këtë numër punuan:

*R.Guri, D.Kalaja, T.Cani, D. Papalilo, E. Valera, L. Lloji,
DH. Hazbiu, E. Beqir-Aga, P. Berberi, R.Eltari, E.Kokona*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Bankën Botërore përmbyll projektin për liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe mundësitë e tarifimit me bazë risku

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) përmbylli projektin për Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri në një *workshop* të organizuar me pjesëmarrjen e të gjitha shoqërive të sigurimit në vend. Ky projekt i cili



po realizohet edhe falë bashkëpunimit me Bankën Botërore, paraqet një mundësi për të kaluar drejt një tarifimi më efektiv, në llogaritjen e primit të sigurimit të detyrueshëm motorik që është ai me bazë riskun. Projekti ka filluar që prej shtatorit të vitit 2011 dhe aktualisht ka të hartuar dokumentet strategjike, që do të përcaktojnë drejtimet kryesore ku do të fokusohen në të ardhmen shoqëritë e sigurimit dhe AMF.

Në prezantimin e këtyre dokumenteve strategjike gjatë *workshop-it* Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi vlerësoi punën e bërë nga ekipi i Bankës Botërore dhe specialistët e AMF-së për ndërtimin e një udhëzuesi i cili do t'i shërbejë si shoqërive të sigurimit ashtu edhe vetë AMF-së në të ardhmen. Znj. Shehi vlerësoi edhe rezultatet e arritura me krijimin pranë AMF-së të Qendrës Kombëtare të të Dhënave për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik, si një njësi mjaft e rëndësishme në drejtim të furnizimit të parametrave të nevojshëm për klasifikimin me bazë risku të marrjes në sigurim të mjetit dhe drejtuesve të tij, duke integruar mundësimin e përqasjes Bonus-Malus.

Ekspertët e Bankës Botërore prezantuan propozimet e tyre për mundësitë që tregu shqiptar ka për ndërtimin e tarifave të primit të sigurimit të detyrueshëm motorik me bazë risku. Ata shpjeguan me detaje duke theksuar eksperiencën e vendeve që e kanë kaluar më parë këtë proces si Italia apo Turqia. Ekspertët theksuan ndërtimin e një baze sa më të plotë të dhënash, përcaktimin e faktorëve që do ndikojnë në përllogaritjen e primeve të sigurimit, rolin shumë të rëndësishëm të teknologjisë së informacionit dhe krijimin e njësisë kundër mashtrimit në sigurimin e mjeteve motorike.

Sipas këtij projekti është hartuar një plan strategjik veprimi me synimin kryesor që tarifat e sigurimit të detyrueshëm motorik të jenë:

- Të drejta për konsumatorin dhe t'i shërbejnë atij;
- Efikase në drejtim të kostos;
- Nxitëse për një drejtim më të sigurt automjeti duke prezantuar sistemin bonus/malus;
- Të qëndrueshme dhe elastike.

Ekspertët theksuan ndërtimin e një baze sa më të plotë të dhënash, përcaktimin e faktorëve që do ndikojnë në përllogaritjen e primeve të sigurimit.

Kushtet aktuale të tregut paraqiten të paqëndrueshme dhe kanë krijuar një presion të tillë që çon në luhatjen e çmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik. Krijimi i një tregu ku çmimet janë të stabilizuara është një detyrë e rëndësishme. Eksperienca botërore tregon se kjo arrihet para së gjithash kur shoqëritë e sigurimit janë të maturuara në drejtim të disiplinave të marrjes në sigurim. Në vende të tjera ku janë zbatuar qasje të ngjashme është dëshmuar që frekuenca e aksidenteve rrugore është përgjysmuar pas një periudhe 15-20 vjeçare.

Në zbatim të këtij projekti, AMF ka bërë përmirësime të ndjeshme në Qendrën Kombëtare të të Dhënave për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik, në drejtim të furnizimit të parametrave të nevojshëm për klasifikimin me bazë rrisht të marrjes në sigurim të mjetit dhe drejtuesve të tij, duke integruar mundësimin e përjasjes Bonus-Malus. Një gjë e tillë, i krijon mundësi shoqërive të sigurimit të llogarisin tarifa sigurimi të lidhura drejtpërdrejt me historikun e dëmeve të drejtuesit të mjetit. Të dhënat e nevojshme merren tashmë në kohë reale nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Gjithashtu në sajë të bashkëpunimit dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, të dhënat e Regjistrimit Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike, tashmë shërbejnë dhe për kontrollin në kohë reale të vlefshmërisë së policave me sistemin e kontrollit online të vendosur në qendrat operative “eGjoba”, me qëllim uljen e numrit të të pasiguarve.

Objektivat themelorë të strategjisë së sigurimit të detyrueshëm motorik janë:

- Çmime të sigurimit të detyrueshëm motorik bazuar në rrisht;
- Ndërtimi i mekanizmave të saktë të grumbullimit të të dhënave;
- Reduktimi i mashtrimeve duke ndërtuar edhe mekanizmat e përshtatshëm për t'i luftuar ato;
- Forcimi i kapaciteteve të siguruesve për të menaxhuar bilancet e tyre;
- Minimizimi i numrit të të pasiguarve;
- Prezantimi i reformave të nevojshme ligjore.

AMF beson që në afatgjatë, përfitimet do të jenë në nivel kombëtar dhe do të lidhen me shpejtësinë dhe maturinë më të cilën vetë shoqëritë e sigurimit do të ecin në këtë proces. Në shumë vende një qasje e tillë e strukturuar ka sjellë përfitime për konsumatorin duke ndikuar edhe në uljen e numrit të aksidenteve dhe promovimin e drejtimit më të sigurt të mjeteve motorike. Ndërkohë, AMF do të vazhdojë të monitorojë me kujdes dhe në mënyrë të vazhdueshme politikën e tarifimit të shoqërive të sigurimit dhe shëndetin e tyre financiar, për të garantuar, që siguruesit disponojnë mjetet e nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj publikut.

Në zbatim të këtij projekti, AMF ka bërë përmirësime të ndjeshme në Qendrën Kombëtare të të Dhënave për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik, në drejtim të furnizimit të parametrave të nevojshëm për klasifikimin me bazë rrisht të marrjes në sigurim të mjetit dhe drejtuesve të tij, duke integruar mundësimin e përjasjes Bonus-Malus.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2013


Duke iu referuar të ardhurave nga primet e shkruara bruto, tregu i sigurimeve në vend në tremujorin e parë të vitit 2013 arriti në vlerën rreth 2.09 miliardë lekë. Ky volum tregon një rritje prej 11.96% krahasuar me tre muajt e parë të vitit të kaluar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012 u rrit gjithashtu edhe numri i policave të sigurimit me 6.36% duke arritur në 232,784 polica sigurimi.

Rritja më e madhe u vërejt në produktet e sigurimit të Jo-Jetës, volumi i të cilave u rrit me 12.29% në periudhën janar-mars 2013 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritje më të vogël patën produktet e sigurimit të Jetës me 5.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e *sigurimit të detyrueshëm motorik* arritën vlerën 1.02 miliardë lekë, me një rritje prej 21.92% nga janar-mars 2012.

Dëmet e paguara bruto regjistruan një ulje me 17.68% gjatë kësaj periudhe krahasuar me periudhën janar-mars 2012.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-mars 2013



Materiali i plotë i raportit statistikor për periudhën janar-mars 2013 gjendet në <http://amf.gov.al/news.asp?id=899>

Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2013

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2013 u dominua në masën 84.09% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 15.91% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 94.87% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Rritja më e madhe u vërejt në produktet e sigurimit të Jo-Jetës volumi i të cilave u rrit me 12.29% në periudhën janar-mars 2013 krahasuar me të njëjtën periudhë e një viti më parë.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2013 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 70.18% dhe 18.28% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.43% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Materiali i plotë mbi tregun e letrave me vlerë për periudhën janar-mars 2013 gjendet në <http://amf.gov.al/news.asp?id=896>

Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare për vitin 2012

Gjatë vitit 2012 në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2012 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 283.01 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 128.27 milionë lekë (82.89%).

E shprehur në euro¹, totali i asetëve nën menaxhim është 2.03 milionë euro. Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në fund të vitit 2012 ishte 7,281 anëtarë duke shënuar rritje prej 15.66% krahasuar me fundin e vitit 2011. Materiali i plotë i mbi tregun e pensioneve gjatë vitit 2012 gjendet në <http://amf.gov.al/news.asp?id=898>

¹Kursi zyrtar i këmbimit (“fiksi”) 31.12.2012 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 139.5 lekë

ZHVILLIME TË TJERA

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi merr pjesë në mbledhjet e nënkomiteteve teknike të IAIS-it

(9-11 prill)

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*) zhvilloi në periudhën 9-11 prill në Bon, Gjermani, takime pune të nënkomiteteve të saj teknike.

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi është anëtare e Nënkomitetit të Gjithëpërfshirjes Financiare (*Financial Inclusion Subcommittee*), i cili është një nënkomitet i krijuar vitin e kaluar pranë IAIS-it me synim për të promovuar tregjet që po lindin dhe sidomos ato në vendet në zhvillim. Ai synon të mbështesë aplikimin e Parimeve Themelore



International Association
of Insurance Supervisors

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.43% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

“Gjithëpërfshirja financiare” si term tregon një gjendje në të cilën të gjithë të rriturit në moshë pune kanë akses në kredi, kursime, pagesa dhe sigurime nga ofruesit formale të këtyre produkteve.

të IAIS-it, rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve, si edhe formave të tjera të sigurimeve.

Duke marrë këtë përgjegjësi, Nënkomiteti i Gjithëpërfshirjes Financiare ndër të tjera do të:

- hartojë materiale studimore rreth Gjithëpërfshirjes Financiare;
- promovojë punën e mekanizmave rregullatore që vendosin standarde;
- rrisë dhe promovojë kapacitetet e politikë-bërësve, rregullatorëve dhe mbikëqyrësve duke kërkuar të ecë më tej në ofrimin e aksesit në tregun e sigurimeve për konsumatorët me të ardhura të ulta duke përfshirë këtu edhe përhapjen e informacionit.

Ky nënkomitet do të zhvillojë takime edhe me organizma të tjerë që janë të përfshirë në iniciativa të ngjashme për rritjen e aksesit të të gjithë popullsisë për produktet financiare, siç mund të jenë edhe iniciativat e G20 për Partneritetin Global për Gjithëpërfshirjen Financiare (*Global Partnership for Financial Inclusion*).

“Gjithëpërfshirja financiare” si term tregon një gjendje në të cilën të gjithë të rriturit në moshë pune kanë akses në kredi, kursime, pagesa dhe sigurime nga ofruesit formale të këtyre produkteve.

Gjithashtu Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi mori pjesë edhe në takimet e Nënkomitetit për Rrjetin e Mikrosigurimeve (*IAIS-Microinsurance Network Joint Working Group*) si edhe të Grupit Hartues për udhëzuesit për çështjet që lidhen me sjelljen e tregut dhe mbrojtjen konsumatore, të zhvilluara në datat 10-11 prill 2013.

Seminar mbi fleksibilitetin e siguresve në kohën e ndryshimeve financiare, Bazel, Zvicër

9-11 prill



Instituti për Stabilitet Financiar (*Financial Stability Institute, FSI*) pranë Bankës për Rregullim Ndërkombëtarë (*Bank for International Settlements, BIS*) organizoi seminarin me temë “Mbi fleksibilitetin e siguresve në një botë financiare në ndryshim”. Seminari u zhvillua në datat 9-11 Prill 2013 në Bazel, Zvicër.

Synimi i seminarit përmes tematikave të trajtuara i shërbeu rritjes së njohurive të mbikëqyrësve në sigurime për një sërë nismash të ndërmarra në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar me synimin për ti bërë siguresit më fleksibël ndaj ndryshimeve të mëdha financiare globale.

Në seminar u diskutuan edhe mjaft nisma që i shërbejnë arritjes së këtij synimi. Ndër këto nisma përmendet ajo e ndërmarrë nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Fondeve të Pensioneve (EIOPA) (*European Insurance and Occupational Pension Authority, EIOPA*) në lidhje me projektin e Solvency II, projekt i cili synon vendosjen e një regjimi prudent për siguruesit dhe risiguruesit në vendet e BE-së. Ky projekt përbën një nga sfidat më të mëdha të punës së EIOPA-s e cila do të shoqërohet edhe me hartimin e udhëzuesve dhe standardeve. Numërohen rreth 53 udhëzues dhe standarde të tilla që duhen hartuar për të mbështetur zbatimin e regjimit të ri, Solvency II. Ky proces parashikohet të përfundojë brenda vitit 2013. Standardet dhe udhëzuesit do të mbulojnë çështje të tilla si kërkesat e kapitalit, fondet e veta, modelet e brendshme, mbikëqyrja e grupit, raportimi dhe transparenca, vlerësimi i aseteve dhe përgjegjësi të tjera nga ato që lidhen me provigjonet teknike dhe drejtimi i shoqërisë.

Në seminar përmes temave të trajtuara u diskutua mbi nevojën e siguruesve për të kuptuar risqet me të cilat ata përballen dhe kërkesat për zbatimin e praktikave të përshtatshme në menaxhimin e tyre.

Çështjet të tjera të trajtuara kishin të bënin me përafrimin dhe kombinimin e kërkesave të Solvency II me riskun e teknikat e menaxhimit të tij, perspektivat e menaxhimit të riskut, arti i mbikëqyrjes, etj. Gjithashtu u diskutua për mësimet e nxjerra nga kriza e fundit financiare globale, siç janë përqsja e standardizuar e modeleve të brendshme të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas eksperiencës së vendeve të BE-së, Zvicrës, Japonisë, SHBA, etj.

Ekspertë të njohur nga EIOPA, IAIS, Deloitte, apo nga autoritetet mbikëqyrëse të Gjermanisë, Japonisë, Zvicrës, Francës dhe SHBA-ve trajtuan në mënyrë interaktive me pyetje dhe diskutime po ashtu edhe nëpërmjet prezantimeve të tyre si aspektet teorike ashtu edhe raste studimore të lidhura me to. AMF u përfaqësua në këtë seminar nga ekspertë në fushën e rregullimit dhe standardeve.


Trajnimi i 23-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë, Uashington, SHBA

15-25 prill

Komisioni i Letrave me Vlerë në SHBA (*Securities Exchange Commission, SEC*) zhvilloi gjatë periudhës 15-25 prill, në Uashington trajnimin e 23-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë. Në këtë trajnim merrnin pjesë përfaqësues nga 72 autoritete të ndryshme rregullatore.

Temat kryesore të këtij trajnimi përfshinin:

Sfidat e rregullatorit të letrave me vlerë. Tematika kryesore lidhej me abuzimet e mundshme me tregun, me konsumatorin dhe rregullat që duhen ndjekur për evitimin e këtyre abuzimeve siç janë rregullat në mbikëqyrje, zbatueshmëri dhe inspektive.



Çështje të tjera të trajtuara kishin të bënin me përafrimin dhe kombinimin e kërkesave të Solvency II me riskun e teknikat e menaxhimit të tij, perspektivat e menaxhimit të riskut, arti i mbikëqyrjes, etj.

Edukimi i investitorëve luan rol në parandalimin e mashtrimeve. Si pika kryesore u theksua nevoja e krijimit të një programi me punonjës të trajnuar dhe kompetentë, të mbështetur nga teknologjia që mundëson investitorët të marrin informacion dhe të kontaktojnë lehtësisht agjencinë mbikëqyrëse.

Skema Ponzi dhe mashtrimi me skemat piramidale. Prezantimet trajtuan mekanizmat e funksionimit të skemave piramidale, investimet mashtruese dhe trajtimi i skemave piramidale më të njohura të viteve në vende të ndryshme.

Ndërtimi i një programi mbi zbatueshmërinë e legjislacionit dhe praktikat më të mira. Nëpërmjet kësaj teme u diskutua mbi forcimin e hetimit dhe ndjekjes së manipulimeve që bëhen në treg. Rëndësi ju kushtua kryerjes së investigimit dhe etapave që ndiqen, bashkëpunimit që duhet të realizohet midis kompanive dhe individëve, përgatitja e një stafi kompetent dhe kërkesat për sjelljen e stafit. Gjithashtu u vu theksi edhe tek zbatimi i ligjeve penale në tregun e letrave me vlerë.

Qeverisja e korporatave. Tema u trajtue si nga analiza mbi teoritë, konceptet dhe principet e saj për qeverisjen. Problemi kryesor lidhej me mbrojtjen e investitorëve të huaj (*pakicat e aksionarëve dhe kreditorëve*) nga shpronësimi i investitorëve të brendshëm (menaxherët dhe aksionarët kontrollues).

Edukimi i investitorëve u cilësua si shumë i rëndësishëm për zhvillimin me sukses të tregut të letrave me vlerë. Kjo lidhet edhe me rritje e numrit të tyre, të produkteve të ndryshme komplekse, të investitorëve “konfuzë”, si dhe mbrojtjen e besimit të tyre. Edukimi i investitorëve luan rol në parandalimin e mashtrimeve. Si pika kryesore u theksua nevoja e krijimit të një programi me punonjës të trajnuar dhe kompetentë, të mbështetur nga teknologjia që mundëson investitorët të marrin informacion dhe të kontaktojnë lehtësisht agjencinë mbikëqyrëse.

Mbikëqyrja dhe zhvillimi i tregut të letrave me vlerë. Qëllimi i kësaj teme ishte shpjegimi i nevojës së një bazë të fuqishme legjislative për funksionimin e tregut të letrave me vlerë.

Tema mbi tregun e brendshëm, manipulimin e tregut, si dhe mashtrimin e kontabilitetit financiar ishin pjesë e rëndësishme e trajnimit. U trajtue studimi për Tregtimin e Shpejtë (*Fast Traders*). Objektivi primar i këtij studimi ishte të mësuarit sesi ekzaminuesit të mund të kryejnë një ekzaminim brokeri. Posaçërisht, ky studim shqyrton rastet kundër pastrimit të parave, tregtisë së paautorizuar, përshtatshmërinë dhe mbikëqyrjen.

Forumi: “Evolucioni Teknologjik i Botës Financiare Sofie, Bullgari

25 prill

Forumi i 15-të “Evolucioni teknologjik i botës financiare u organizua nga Grupi për të Dhëna Ndërkombëtare (*International Data Group of Bulgaria, IDG*), Shoqata për Auditivin dhe Kontrollin e Sistemeve të Informacionit, (*Information Systems Audit and Control Association, ISACA*) dhe qendra Informacioni, Teknologjia e Komunikimit dhe Media, (*Information, Communications Technology and Media-ICT Media*). Ky forum u mbajt në



25 prill edhe falë bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Bullgarisë dhe Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare. Forumi prezantoi sfidat e reja, zgjidhjet dhe tendencat që lidhen me menaxhimin, zgjerimin dhe mbrojtjen e informacionit. Ai paraqiti shembuj për optimizmin e aseteve teknologjike duke përdorur platforma të reja për zhvillimin e produkteve të reja bankare dhe të sigurimeve.

Ndër tematikat kryesore të trajtuara ishin:

1. Zbatimi që teknologjia e informacionit ka në institucionet financiare;
2. Mbështetja që jep teknologjia e informacionit për aktorët e tregjeve financiare;
3. Krijimi i shërbimeve të reja për bankat dhe klientët e tyre duke përdorur teknologjinë e informacionit;
4. Sistemi i pagesave SEPA si kërkesë për pjesëmarrësit e tregut financiar evropian;
5. Sfidat lidhur me aplikimin e teknologjisë së informacionit për kontrollin e institucioneve financiare;
6. Teknologjitë e reja-të nevojshme për efektivitetin mbikëqyrës financiar;
7. Menaxhimi i riskut lidhur me sistemet financiare bankare dhe të sigurimeve.

Pjesëmarrësit në këtë forum ishin ekspertë të teknologjisë së informacionit në nivel rajonal. Folës kryesorë ishin përfaqësues nga Banka Qendrore Evropiane, si edhe ekspertë nga Austria dhe Bullgaria.

Forum i prezantoi sfidat e reja, zgjidhjet dhe tendencat që lidhen me menaxhimin, zgjerimin dhe mbrojtjen e informacionit. Ai paraqiti shembuj për optimizmin e aseteve teknologjike duke përdorur platforma të reja për zhvillimin e produkteve të reja bankare dhe të sigurimeve.

Mbledhja e katërt e Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, Bruksel

26 prill

Në datën 26 prill 2013, në Bruksel, pranë ambienteve të Komisionit Evropian u mbajt mbledhja e katërt e Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, përfshi dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit. Shqipëria u përfaqësua nga një delegacion i përbërë me përfaqësues të lartë të të gjitha institucioneve, sipas programit të takimit.



Për të gjitha pikat diskutimeve në takim u mbajtën në konsideratë zhvillimet më të fundit që nga Nënkomiteti i prillit 2012, me fokus të veçantë zhvillimet pas Raportit të Progresit të muajit tetor 2012, zbatimin e MSA dhe ndihmën aktuale që EU dhe organizatat e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare po i japin Shqipërisë.

Ndërgjegjësimi i ulët i popullsisë në Turqi për riskun po ndryshon. Pjesërisht kjo është e lidhur me zbatimin më të mirë të legjislacionit mbi format e sigurimit të detyrueshëm, si për sigurimin e mjeteve motorike ashtu edhe për sigurimin nga tërmeti.

Sigurimi nga tërmeti për shtëpitë e reja është tashmë një kusht për lidhjen e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të tyre. Por ky sigurim është gjithashtu kusht për shkak të popullatës së re të Turqisë (rreth 30 % e të cilave është nën moshën 30 vjeç), të cilët kanë më tepër me më shumë mundësi se sa prindërit e tyre për të mbajtur karta krediti dhe për të blerë shtëpitë e ndërtuara rishtas. Të dy këta faktorë kanë rritur politikat e shitjes së sigurimit të shtëpive gjatë dekadës së kaluar. Gjithashtu ka ndihmuar edhe vetë sektori i sigurimeve duke ofruar një shumëllojshmëri të produkteve për të apeluar tek konsumatorët e rinj.

Për këtë numër punuan:

*R.Guri, D.Kalaja, T.Cani, D. Papalilo, E. Valera, L. Lloji,
DH. Hazbiu, E. Beqir-Aga, P. Berberi, R.Eltari, E.Kokona*